

PËR Q. 7 VIKU  
24.01.2018

421/4  
24.01.2018



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit -Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-**  
**Ministry of Culture, Youth & Sports**

**Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge**  
**Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage**  
**Prizren**

<b>DATË/A:</b>	24.01.2018
<b>REFERENC-Ë:</b>	Nr. 421/4
<b>PËR/ZA/TO:</b>	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor KK Prizren
<b>CC:</b>	
<b>PËRMES/PREKO/THROUGH:</b>	
<b>NGA/OD/FROM:</b>	Jusuf Xhibo - U.D. i QRTK-së Prizren
<b>TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:</b>	Refuzim

Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, neni 6 (paragrafi 7, 8 dhe 9), dhe në bazë të Ligjit Nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 5 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 1.4, 2.3), 8, 9 (paragrafi 2), 11, 16 (paragrafi 1 dhe 2), 17 (paragrafi 1), 21 (paragrafi 3); Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturore në Prizren lëshon:

**REFUZIM**

Investitorit Emrah Çabrati nga Prizreni, rruga "Adem Jashari" nr. / i refuzohet kërkesa për ndërtim të objektit – banim me lokal afarist, ngastra kadastrale nr. 00804-0 K.K. Prizren.

## A r s y e t i m

Kërkesa e parashtruar nga investitori për ndërtim të objektit – banimi me lokal afarist nga dispozicioni i këtij rekomandimi gjendet në Zonën Mbrojtëse të qytetit sipas Planit Zhvillimor Urban të Prizrenit. Në parcelën ku parashihet ndërtimi i objektit të ri gjendet një ndërtesë e vjetër e cila i takon fillimit të shek. XX, dhe është ndërtuar me teknikë tradicionale të ndërtimit.

Ndërtesa është e vendosur në varg, me fasadën ballore të orientuar kah rruga. Fasada ballore është punuar me elemente dekorative lineare, karakteristikë e fillimit të shek. 20 (vitet 1930). Pranë kësaj ndërtese gjenden edhe katër ndërtesa tjera të cilët datojnë nga kjo periudhë.

Duke marrë parasysh se ky potez ndodhet në vazhdimësi të rrugës Adem Jashari, i cili fillon nga Hamami i Gazi Mehmed Pashës, dhe ka të ruajtur karakterin historik të çarshisë tradicionale të zhvilluar në vijë kontinuale, komisioni ka vlerësuar se ky varg i ndërtesave posedon vlera historike dhe paraqet një dëshmi të zhvillimeve urbanistike dhe arkitektonike nëpër periudha të ndryshme. Duke marrë parasysh ndërhyrjet brutale që janë bërë në këtë rrugë, ndërtesa të reja që nuk i përmbahen konturës, gabaritit dhe stilit arkitektonik ekzistues, **Komisioni ka vlerësuar që në këtë potez nuk duhet të priset ansambli arkitektonik, rrjedhimisht që gabariti dhe fasada perëndimore – ballore nuk duhet të rrënohet / priset.**

Bazuar në kompetencat e QRTK Prizrenit të caktuara sipas Rregullores për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente (Nr. 06/2017), respektivisht sipas Nenit 14. dhe 16, QRTK ka shqyrtuar lëndën në fjalë. Pas shqyrtimit të Komisionit për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave dhe projekteve konservuese, restauruese të trashëgimisë kulturore, Komisioni unanimisht ka vendosur që të refuzohet kërkesa e palës për ndërtim të ri në këtë parcelë, me projektin e prezantuar.

Projekti për ndërtim në këtë parcelë duhet të punohet duke marrë parasysh kushtin e cekur më lartë.

11  
e pranuar  
14.12.2017  
*[Signature]*

Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage  
Prizren

421/2  
14.12.2017



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
**Qeveria -Vlada-Government**

**Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit –Ministarstvo Kulture, Omladine i Sporta-**  
**Ministry of Culture, Youth & Sports**

**Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë / Regionalni Centar za Kulturno Nasledje / Bölge**  
**Kültürel Miras Merkezi / Regional Center for Cultural Heritage**  
**Prizren**

DATË/A:	14.12.2017
REFERENC-Ë:	Nr. 421/2
PËR/ZA/TO:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor KK Prizren
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Jusuf Xhibo - U.D. i QRTK-së Prizren
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rekomandim për plotësim të dokumentacionit

Në bazë të Ligjit Nr. 02/L-88 për Trashëgimi Kulturorë, neni 6 (paragrafi 7, 8 dhe 9), dhe në bazë të Ligjit Nr. 04/L-66 për Qendrën Historike të Prizrenit, neni 5 (paragrafi 1), 6 (paragrafi 1.4, 2.3), 8 , 9 (paragrafi 2), 11, 16 (paragrafi 1 dhe 2), 17 (paragrafi 1), 21 (paragrafi 3), Qendra Rajonale për Trashëgimi Kulturorë në Prizren lëshon:

**REKOMANDIM**

Investitorit Emrah Çabradi nga Prizreni, rruga "Adem Jashari" nr. / kërkohet që të kthehet lënda për plotësim të mëtejme të dokumentacionit, ngastra kadastrale nr. 00804-0 K.K. Prizren.

Ekipi i QRTK Prizren ka realizuar vizitën në vendin ku është parashtruar kërkesa për ndërtim. Në këtë parcelë gjendet një ndërtesë e vjetër tradicionale, me etazhitet P+1, e punuar me materiale dhe teknikë tradicionale të ndërtimit.

Duke marrë parasysh se ky potez ndodhet në vazhdimësi të rrugës Adem Jashari, i cili fillon nga Hamami i Gazi Mehmed Pashës, dhe ka të ruajtur karakterin historik të çarshisë tradicionale të zhvilluar në vijë kontinuale, komisioni ka vlerësuar se ky varg i ndërtesave posedon vlera historike dhe paraqet një dëshmi të zhvillimeve urbanistike dhe arkitektonike nëpër periudha të ndryshme.

Nga pala kërkohet të plotësohet projekt – propozimi me këto elemente:

- 1.1. Të hartohet projekti i gjendjes ekzistuese të ndërtesës dhe oborrit me objektet përcjellëse, të paraqitur në:
  - 1.1.1. Situacion;
  - 1.1.2. Baza e përdhësës;
  - 1.1.3. Baza e katit;
  - 1.1.4. Prerja; dhe
  - 1.1.5. Dy fasadat.
- 1.2. Të paraqitet raporti i qëndrueshmërisë statike të ndërtesës ekzistuese.

## **A r s y e t i m**

Kërkesa e parashtruar nga investitori për ndërtim të objektit – banimi me lokal afarist nga dispozicioni i këtij rekomandimi gjendet në Zonën Mbrojtëse të qytetit sipas Planit Zhvillimor Urban të Prizrenit. Në parcelën ku parashihet ndërtimi i objektit të ri gjendet një ndërtesë e vjetër e cila i takon fillimit të shek. XX, dhe është ndërtuar me teknikë tradicionale të ndërtimit.

Bazuar në kompetencat e QRTK Prizrenit të caktuara sipas Rregullores për caktimin e institucioneve publike të trashëgimisë kulturore, vartëse të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, në cilësinë e institucioneve kompetente (Nr. 06/2017), respektivisht sipas Nenit 14. dhe 16, QRTK ka shqyrtuar lëndën në fjalë. Pas shqyrtimit të Komisionit për shqyrtim dhe vlerësim të kërkesave dhe projekteve konservuese, restauruese të trashëgimisë kulturore, është vlerësuar se lënda duhet të kthehet për plotësim të mëtejme të dokumentacionit.